



14620/25
- 2 -
09.04.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

02Nr. PB 445 / 2025
Më 09.04.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, nenin 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr. 23/2023 për Procedurat e punës në Tryezat Multidisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit dhe nenit 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIM TË TRYEZËS MULTIDISCIPLINARE PËR NDIHMË PËR
MENAXHIM TË RASTIT


1. Me këtë vendim themelohet Tryeza Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit në Komunën e Vushtrrisë.
2. Tryeza Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit ka këtë përbërje:
 - 2.1 Gazmend Mehulli, Menaxheri i rastit nga Qendra për Punë Sociale;
 - 2.2 Valmire Hyseni Haradinaj, Ndhmës menaxhere e rastit nga QPS;
 - 2.3 Shërbimi Sprovues i Kosovës, Zyrtari i Shërbimit Sprovues;
 - 2.4 Hasan Rama, Qendra e Mjekësisë Familjare – mjekë specialist;
 - 2.5 Përfaqësuesi i Policisë së Kosovës;
 - 2.6 Edona Shotani, Drejtorja për Arsim – zyrtare për arsim (psikologe);
 - 2.7 Shkelzen Osmani zyrtar në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
 - 2.8 Floriana Spanca, Pedagoge e shkollës;
 - 2.9 Ekrem Merovci, Zyra Komunale për Komunitete – Zyrtar për komunitete;
 - 2.10 Remzije Zekolli, Zyrtare për Barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut/fëmijës
 - 2.11 Lirim Kosumi OJQ "Hareja" Vushtrri.
3. Tryeza Multidisiplinare udhëhiqet nga menaxheri i rastit dhe ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 3.1 Trajton rastet specifike të abuzimit, këqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pas dore, në bazë të interesit më të mirë të fëmijës.
 - 3.2 Përcjell dhe në vazhdimësi rishqyrton vlerësimin e rastit të bërë paraprakisht nga menaxheri i rastit, duke e plotësuar me informata të përditësuara varësisht nga ndryshimi i gjendjes së fëmijës apo rrethanave të rastit
 - 3.3 Bashkërendon dhe zhvillon procesin e planifikimit të përbashkët të veprimit për mbrojtje të fëmijës

- 3.4 Koordinon ofrimin e shërbimeve për Mbrojtje, rehabilitim, dhe riintegrim apo riintegrim të fëmijës në mënyrë të qëndrueshme dhe përkrahë familjet e tyre ose kujdestarin;
 - 3.5 Rishikon planin individual për mbrojtjen e fëmijës në baza mujore, në raste specifike edhe më shpesh
 - 3.6 Harton raportin vjetor për punën e vet dhe raporton te komuna dhe sipas kërkesës edhe Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli për të Drejtat e Fëmijës.
4. Tryeza Multidisiplinare mbyll rastin kur vlerësohet se të gjitha shërbimet e nevojshme janë ofruar dhe është ulur niveli i rrezikut apo nuk ka rrezik për mirëqenien e fëmijës.
 5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Tryezës Disiplinare
- QSHQ
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

02Nr. 449 /25

Datë, 07.04 2025

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 8 pika 2, 3 dhe 4 të Rregullores së MF – NR. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve si dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, me propozim të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport datë 07.04.2025, Kryetari i Komunës merr,

V E N D I M
PËR THEMELIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR NDARJE TË
SUBVENCIONEVE NGA DKRS PËR OJQ-të E KOMUNËS


1. Themelohet Komisioni Vlerësues për vlerësim të aplikacioneve sipas thirrjes publike të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport për ndarje të subvencioneve për OJQ-të e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.
2. Në përbërje të komisionit vlerësues caktohen:
 - 2.1 **Qemajl Hasani**, Kryesues i komisionit
 - 2.2 **Bashkim Sadiku**, anëtar
 - 2.3 **Mirjeta Duraku**, anëtare
 - 2.4 **Arlind Rashica** anëtar
 - 2.5 **Lavdim Feka**, OJQ, anëtar
 - 2.6 **Sabri Dallku**, anëtar rezervë.
3. Anëtar i rezervë do të zëvendësoj në rast nevojë anëtarin e Komisionit Vlerësues i cili ka konflikt interesi me ndonjërin prej aplikuesve për subvencion.
4. Komisioni Vlerësues me rastin e vlerësimit të aplikacioneve dhe përzgjedhjes së përfituesve do të zbatoj procedurat e përzgjedhjes konform dispozitave të Rregullores së MF – NR. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
5. Komisioni Vlerësues në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision. Këto rregulla bëhen publike brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit.

6. Komisioni Vlerësues ka mandat deri në fund të vitit 2025.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i ju dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport,
- Anëtarëve të Komisionit Vlerësues
- QSHQ
- Arkivit .



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

02 Nr. 428/25

Kryetari

Me: 02.04.2025

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, nenin 8 paragrafi 1 të Rregullores (KKV) nr.01/2023 për Ndarjen e Bursave për Nxënës, Student dhe Shpërblimeve për Nxënës, Student të Komunës së Vushtrrisë prot.01 nr.47/23, datë 23.02.2023, me propozim të Drejtorisë për Arsimit datë 02.04.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIM TË KOMISIONIT PËR NDARJEN E BURSAVE

1. Themelohet komisioni për ndarje të bursave për student të Komunës së Vushtrrisë për vitin akademik 2024/2025, në këtë përbërje:
 - 1.1 z. **Enver Bajrami** – Kryesues i komisionit,
 - 1.2 znj. **Sadete Gërguri**, anëtare
 - 1.3 z. **Hashim Hajrizi**, anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do zbatoj procedurat e ndarjes së bursave për student të Komunës së Vushtrrisë për vitin akademik 2023/2024, konform kriterëve për përfitim të bursës, të përcaktuara në Rregulloren në fuqi për Ndarjen e Bursave për Nxënës, Student dhe Shpërblimeve për Nxënës, Student të Komunës së Vushtrrisë.
3. Komisioni ka mandat njëvjeçar (për vitin shkollor/akademik).
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- QSHQ
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



02Nr. 446/25
Datë, 07.04.2025

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), nenit 16 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 08/L-264 për Rininë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16, datë 09 Gusht 2024) nenit 10 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ (MKRS) Nr. 11/2024 për Qendrat Rinore, nenit 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe Rekomandimit datë 03.04.2025 të Komisionit për dhënie të lejes organizatës joqeveritare për menaxhimin e Qendrës Rinore "Fahri dhe Naxhije Buçinca" në Vushtrri, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIE TË LEJES PËR MENAXHIM TË QENDRËS RINORE
"NAXHIJE DHE FAHRI BUÇINCA" NË VUSHTRRI

1. Me këtë vendim, Organizatës Joqeveritare "Hareja" në Vushtrri i ipet leja për menaxhim, të objektit të QR. "Naxhije dhe Fahri Buçinca" në Vushtrri, kati i parë, me mundësi të shfrytëzimit sipas nevojës dhe me miratim të Drejtorit për Kulturë Rini dhe Sport, edhe të dy sallave të kësaj qendre.
2. Leja për menaxhim sipas pikës paraprake të këtij vendimi ipet në kohëzgjatje prej tri (3) viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Organizata Joqeveritare "Hareja" në Vushtrri do të menaxhoj hapësirat e qendrës rinore në pajtim me dispozitat e nenit 16 të Udhëzimit Administrativ (MKRS) Nr. 11/2024 për Qendrat Rinore.
4. Leja për menaxhim mund të revokohet para kalimit të afat të cekur në pikën paraprake të këtij vendimi, në rastet e përcaktuara në nenin 13, 14 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ (MKRS) Nr. 11/2024 për Qendrat Rinore.
5. Në rast të revokimit, organizata joqeveritare nuk ka të drejtë të riaplikojë për leje për së paku një (1) vit nga publikimi i vendimit të Komisionit për revokim të lejes.
6. Komuna do të mbuloj shpenzimet komunale të qendrës rinore për kohën e menaxhimit nga OJQ "Hareja" në Vushtrri, siç është përcaktuar në nenin 17 të Udhëzimit Administrativ (MKRS) Nr. 11/2024 për Qendrat Rinore.
7. Të drejtat obligimet dhe përgjegjësitë tjera për shfrytëzim të hapësirave për të cilat ipet leja do të rregullohen me marrëveshje të veçantë në mes të OJQ "Hareja" dhe Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Vushtrri.
8. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Ar sy et im

Organizata Joqeveritare "Hareja" në Vushtrri ka aplikuar për dhënie të lejes për menaxhim të Qendrës Rinore "Naxhije dhe Fahri Buçinca" në Vushtrri bazuar në njoftimin për konkursin për aplikim të publikuar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport dt. 21.02.2025. Komisioni i themeluar për shqyrtim të kërkesave të OJQ-ve me rastin e shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar për aplikim

ka gjetur se vetëm OJQ "Hareja" në Vushtrri ka aplikuar për leje për menaxhim të kësaj qendre rinore. Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar ka konstatuar se kjo OJQ i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e kërkuara në njoftimin për aplikim ashtu siç janë parapa me dispozitat e Udhëzimit Administrativ të (MKRS) Nr. 11/2024 për Qendrat Rinore.

Andaj me rekomandimin nr. 14189/25 datë 03.04.2025 ka kërkuar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport dhe Kryetari i Komunës që të merret vendim me të cilin kësaj OJQ-je të i ipet e drejta për menaxhim të Qendrës Rinore "Naxhije dhe Fahri Buçinca" në Vushtrri në kohëzgjatje të përcaktuar me dispozita ligjore me të cilat është rregulluar kjo çështje.

Nga se u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLIM JURIDIK: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi. Ankesa i paraqitet komisionit për ankesa i themeluar me vendim nga kryetari i komunës.



Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport
- OJQ "Hareja" në Vushtrri
- QSHQ
- Arkivit